



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

VENDIM

Nr. 100, Datë 09.05.2022

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË  
“ALBANIAN GREEN ENERGY” SH.P.K., ME NR. 376, SERIA F12/17, NË  
VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, MIRATUAR ME  
VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 106, DATË 20.07.2012, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “d”, nenit 5, pika 1, gërma “d”, nenit 10, pika 3, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, si dhe nenit 19, pika 1, gërma “a”, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 09.05.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 608/1 prot., datë 27.04.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi fillimin e procedurës për rinovimin e licencës së shoqërisë “Albanian Green Energy” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

**Konstatohet se:**

- Shoqëria “Albanian Green Energy” sh.p.k. me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 577 prot., datë 19.04.2022, ka paraqitur kërkesën për të rinovuar licencën në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për rinovimin e licencës së furnizimit të energjisë elektrike në zbatim të Aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar.
- Në zbatim të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, aplikanti duhet të depozitojë në ERE: Formatin dhe dokumentacionin për aplikim; Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor; Dokumentacionin financiar dhe fiskal dhe çdo modifikim

ose ndryshim të mundshëm të dokumentacionit të të dhënave teknike. Sa rezulton nga ky aplikim shoqëria ka përcjellë dokumentacionin si vijon:

- Formati dhe dokumentacioni për aplikim, Neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b” dhe “c”. **Plotësuar.**
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, Neni 9, pika 2, gërmat “a”, “b” dhe “e”. **Plotësuar.**
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal, Neni 9, pika 3, gërmat “b”,” dhe “d”. **Plotësuar.**
- Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, Neni 9, pika 4.7 , gërmat “a”, “c”, “d”, “f” h, dhe “i”. **Plotësuar.**

Në lidhje me dokumentacionin e munguar që ka të bëjë me:

Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, Neni 9, pika 2:

- **gërma “c”** (Vërtetim për regjistrimin dhe ekstrakt historik nga Qendra Kombëtare e Biznesit QKB)., shoqëria duhet të përcjellë në ERE edhe Certifikatën e Regjistrimit pranë QKB-së.
- **gërma “d”** (Vërtetimi nga Prokuroria dhe Gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë)., Në lidhje me këtë kërkesë të rregullores konstatohet se mungon vërtetimi i gjykatës për përfaqësuesin me autorizim të shoqërisë dhe vërtetimi i prokurorisë për vetë shoqërinë, të cilat në vijim shoqëria duhet t’i depozitojë në ERE.

Dokumentacioni financiar dhe fiskal Neni 9, pika 3:

- **gërma “a”** (vërtetimi për shlyerjen e tatimeve dhe sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore), Shoqëria duhet të depozitojë në ERE edhe vërtetimin për detyrimet tatimore.
- **gërma “c”** (dokumenta që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit ku shprehen qartë vlerat monetare për financimin dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacion, të tjera). Shoqëria duhet të përcjellë në ERE kapitalin financiar që vë në dispozicion të veprimtarisë së furnizimit të energjisë elektrike.

Dokumentacioni teknik për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike, Neni 9 , pika 4.7

- **gërma “b”** (Kapitali financiar (i shprehur në vlera monetare) i parashikuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie, i shoqëruar me vërtetim nga banka apo institucione të tjera financiare të njohura me ligj). Shoqëria duhet të specifikojë se sa kapital financiar vë në dispozicion të veprimtarisë së furnizimit të energjisë elektrike.
- **gërma “e”** (Sistemin IT të krijuar për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike apo marrëveshje me të tretët për vënien në dispozicion/përdorimin e këtij shërbimi) Shoqëria duhet të përcjellë në ERE sa kërkon kjo pikë e rregullores.
- **gërma “g”** (Dokumentacion që vërteton aftësinë e disponimit të zyrave përfaqësuese të furnizuesit, për shërbimet që do t’i ofrohen klientëve). Shoqëria duhet të përcjellë dokumenta në lidhje me këtë kërkesë të rregullores.

- Shoqëria “Albanian Green Energy” sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 376, Seria F17, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike që nga data 27.07.2017, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 114, me afat vlefshmërie deri në datën 27.07.2022.
- Në nenin 16, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, përcaktohet se paraqitja e kërkesës për rinovimin e licencës bëhet jo më vonë se 2 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë.
- Shoqëria e ka paraqitur aplikimin e saj më datë 19.04.2022, pra brenda afatit të parashikuar në nenin 16, pika 1, të rregullores.
- Shoqëria “Albanian Green Energy” sh.p.k. ka kryer të gjitha pagesat e rregullimit ndaj ERE-s.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të fillojë procedurën për rinovimin e licencës nr. 376, Seria F17, të shoqërisë “Albanian Green Energy” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit nr. 114, datë 27.07.2017, i ndryshuar, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 08.06.2022.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**